



AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Termat e Referencës

Pozicioni:	Ekspert lokal
Vendodhja:	Mal i Zi
Fillimi i Punës:	24.02.2020
Mbarimi i Punës:	30.04.2020
Kohëzgjatja:	6 ditë punë

Projekti

Ditët e sotme burgjet janë mjedise multi-etnike. Diversiteti etnik dhe kulturor i të burgosurve paraqet sfida të shumëfishta për stafin e vijës së parë në burgje, të cilët përballen më kultura e gjuhë të “panjohura”, fenomenin e nën-kulturës dhe episode të mundshme radikalizimi dhe ekstremizmi. Manaxhimi i aspekteve multi-kulturore në ambjentet e burgjeve është një çështje prioritare në legjislacionin e BE-së, sic theksohet edhe në Rekomandimin Cm/Rec(2012)12 të Këshillit të Ministrave. Nisur nga kjo ka lindur nevoja që stafi i burgjeve të marrë trajnimet e duhura për tu përballur me nevojat dhe të drejtat e të burgosurve të huaj. Në këtë kuadër, projekti 2 vjeçar “B-ComPetent – Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe” ka për qëllim të kontribuojë në aplikimin koherent dhe efektiv të legjislacionit dhe standardeve të BE lidhur me trajtimin e të burgosurve të huaj nëpërmjet ndërtimit dhe implementimit të një programi të tipit “train-the-trainers” (ballë-për-ballë dhe e-learning), kombinuar me praktikat më të mira, aksione për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mjeteve praktike multi-gjuhësore. Avokati i Popullit në bashkëpunim me gjashtë partner, janë duke implementuar projektin nr. 854040 “*Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe*” i bashkëfinancuar nga Programi i Drejtësisë së BE (2014-2020).

Objektivi

Avokati i Popullit kërkon të rekrutoj një Ekspert Lokal, i cili do të jetë përgjegjës për të kryer aktivitetet e 2 Fokus Grupeve dhe hartimin e një raporti lidhur me takimet e fokus grupeve i cili do të ketë bashkëngjitur axhendën, minutat e takimit, listëprezencat e firmosura sipas kuadrit të projektit nr. 854040 “*Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe*”.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Avokati i Popullit do të kërkoj kryerjen e shërbimeve nga **një Ekspert Lokal**, i cili do të jetë përgjegjës për organizimin e 2 Fokus Grupeve në Malin e Zi.

Më specifikisht, eksperti do të:

- Moderoj 2 takimet e Fokus Grupeve në Malin e Zi
- Hartoj Axhendën dhe Listeprezencat
- Përmbledhë minutat e takimeve
- Hartoj një raport mbi Fokus Grupet e zhvilluara.

Kriteret e veçanta

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në shkencat juridike
- Të ketë përvojë profesionale në fushën e të drejtave të njeriut dhe fushat të përafërta.
- Të ketë njohje të thellë të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar
- Të ketë aftësi organizative dhe administrative si dhe veçanërisht aftësi komunikimi
- Të ketë standarde të larta të integritetit dhe përvojës në trajtimin e informacionit konfidencial

Aplikanti duhet të dorëzoj:

1. Letër motivimi
2. Curriculum vitae
3. Cdo dokument shtesë që lidhet me aplikimin

Afati i aplikimit: 17 Shkurt 2020

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

Adresa: Avokati i Popullit, Bulevardi Zhan D’Ark nr. 2, Tiranë